



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.511/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Afijete Sada - Gllgjani dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e BIRN dhe Internews/Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkëljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - Thyerja e heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datën 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet e palejuar ankesa A.nr.511/2021 e dates 15.02.2021, e paraqitur nga Birn dhe Internews/Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, pasi që për të njëjtën çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 419/2021 të datës 15.02.2021

A r s y e t i m

Birn dhe Internews/Kosova (IKS), ka parashtruar ankesë A.nr.511/2021 me datë 15.02.2021, me të cilën pretendon se subjekti politik PDK ka thyer heshtjen zgjedhore pasi që ka dërguar një komunikatë përmes te cilit ka njoftuar se kryetari i subjekti politik PDK Enver Hoxhaj ka votuar për rimëkëmbje. Parashtruesi i ankesës thekson se rimëkëmbja ka qene slogani i PDK-së në këto zgjedhje ndërsa komunikatën e saj PDK-së thekson “Sot vendoset për rimëkëmbjen ose mjegullën e izolimit ndërkombëtar “ Parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik PDK ka shkelur LZP-në dhe ka thyer heshtjen zgjedhore te sanksionuar me nenin 6 .2 Rregullës Zgjedhore 01/2012 për Kategorizimin e sanksioneve dhe si provë ka bashkangjitur komunikatën për rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit të lejshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Birn dhe Internews/Kosova (IKS), ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesat e parashtruara nga subjekti politik LVV dhe nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të paraqitura me datën 14.02.2021 kundër subjektit politik PDK e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 419/2021 të datës 15.02.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se ankesa e parashtruar nga Birn dhe Internews/Kosova (IKS) është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 419/2021 të datës 15.02.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 511/2021 më datën 16.02.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së,